Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**17.08.2023**	**07.09.2023**	**2023/0590**
Eksperti Teknik **Lindita Aliaga**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **25.08.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.08.2023, OE "Adnan A. Bala B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0590, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me paisje mjeksore" me nr. të prokurimit: "10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI SHEIKH ZAYED.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë: të hapur, lloji i kontratës: furnizim vlera e parashikuar e kontratës: **39,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë,07.07.2023, data e hapjes së ofertës: 8.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi i ligjit;

Neni 7 Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi

Neni 28-Specifikimet teknike.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa 4. Deklarata për specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu i prodhuesit.

Evidenca 4. Ofertuesi duhet qe ta jape një deklarate për specifika teknike si dhe duhet te bashkangjitet katalogu i prodhuesit për secilin artikull të ofruar, ku duhet të nënvizohen specifikat teknike te produktit.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Adnan A. Bala B.I.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues/ teknik , sqaron se OE ankues "Adnan A. Bala B.I.", ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me kërkesat e vendosura ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, për te cilat i njëjti ka kërkuar kërkesa për informacione shtesë për Lot 2 dhe Lot 3, lidhur me kërkesat për te cilat ka kërkuar sqarime, ka marr përgjigje negative dhe i njëjti parashtron ankese ne OSHP, me pretendimin se kërkesat janë favorizuese dhe diskriminuese për OE-te te cilët shprehin interes për ketë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-se.

Lidhur me ketë pretendim AK, ka dhëne ketë përgjigje:

Bazuar ne Nenin 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe te një kërkesë për Rishqyrtim nga OE, Autoritetit Kontraktues-Spitali"Sheikh Zayed"-Vushtrri, e mori ketë:

VENDIM

Kërkesa për Rishqyrtim Refuzohet

Arsyetim

Lidhur me tenderin **"Furnizim me paisje mjeksore"** ref nr **10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1**

dhe nr i brendshëm: **70050-23-016-1-1-1** me datë: **13.08.2023**,në AK-Spitali"Sheikh Zayed", është pranuar një kërkesë për rishqyrtim, nga OE **ADNAN A BALA BI** me arsyetimin se:

Pretendimet e OE ADNAN A BALA BI, Ne lidhje me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me paisje mjeksore"LOT 2 dhe LOT3 dhe me numer të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-6982-1-1-1** ne dosjen e tenderit janë shkelur Dispozitat Ligjore të LPP tek DT:

- Specifikat teknike të detyrushme i janë përshtatur në tërsi një prodhuesi të caktuar dhe favorizuese për ndonje OE të caktuar.

Përgjigjja e AK-

Arsyetim: Pretendimet e OE nuk qendrojnë sepse Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar proceduren e tenderimit sipas LPP-së, në përputhje me dispozitat e ligjit ne fuqi dhe Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik.

Ne si AK mendojm se pregaditja e specifikave teknike nuk është diskrimkinuese për OE sepse për të qenë transparent ndaj OE, tenderin e kemi ndarë në tri pjesë (Loto) dhe është i hapur për të gjithë OE për të ofertuar të cilët i plotsojnë kushtet dhe kërkesat sipas DT. Kështu që **Referojuni Dosjesë së Tenderit.**

Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktuesi Spitali"Sheikh Zayed"-Vushtrri e refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të **pa bazuar.**

Eksperti teknik sqaron se, OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore te LPP-se,

si me poshtë:

Pretendimet ankimore se specifikimet teknike te detyrueshme i janë përshtatur ne tërësi një prodhuesi te caktuar dhe kjo është kundërshtim me Nenin 7 dhe 28 te LPP-se, sepse janë specifika favorizuese dhe diskriminuese për prodhues tjerë dhe OE qe shprehin interes për ofertim përmes procedurës se hapur qe është qëllimi konkurrence dhe trajtim i barabarte. Duke marr parasysh se AK sidomos ne instucione shendetesore jane duke bere vlersim po thuaj shkronje per shkronje apo number per number ku keto vlersim po eliminoj te gjitha oferta e OE edhe rrjedhimisht AK po abuzojn me parane publike duke mos marr parasysh qellim e pasijeve dhe aktivitetin e prokurimit.

Ne sqarime e dhëna nga AK nuk jep mundësi OE tjerë pjesëmarr te tender duke mos japë mundesi te ofertoj me paisjet te peraferta po me devijime te vogela por vetem identike, ju lutem shikoni Vendim e AK per Refuzim te Kërkesë për rishqyrtim te dates 15.08.2023.

LOT 3 - Furnizim me paisje mjeksore

Specifikim teknike te detyrueshme janë favorizuese për një OE te caktuar sepse te gjitha parametrat teknike te kërkuara ne dosje te tenderit i përputhen ne tërësi produktit- modeli e cekur me poshte.

Pra jane vetem kopy/past shiko pozicioni 1 dhe pozcioni 2 jane të proshuesi Aspel shik pozicion 1 dhe link https://www.aspel.com.pl/en/comparison-tool,9 vetem me disa ndryshime te vogela te cilat kane pesaur gjate perkthim nga anglisht ne sqip.
Pozcioni 3 dhe 4 jane te prodhuesit Turmed pra jane vetem kopy/past shiko provat dhe deshmit e bashkangjiture pra prova me nr 1 dhe prova e nr 2 pra jane kopy/past vetem me disa ndryshim te vogela gjate perkthimit ku edhe modelin e ka percaktur AK pra modelin 4- Shtreter per pacient te urgjences TM- C3033 pra shiko deshmin me poshte apo Proven 1 ose link **https://www.turmedonline.com/Urun/emergency-stretcher_5553**.

Pozcioni 3 dhe 4 jane te prodhuesit Turmed pra jane vetem kopy/past shiko provat dhe deshmit e bashkangjiture pra prova me nr 1 dhe prova e nr 2 pra jane kopy/past vetem me disa ndryshim te vogela gjate perkthimit ku edhe modelin e ka percaktur AK pra modelin 4- Shtreter per pacient te urgjences TM- C3033 pra shiko deshmin me poshte apo Proven 1 ose link https://www.turmedonline.com/Urun/emergency-stretcher_5553.

4	Shtreter per pacient te urgjences TM- C3033	copë	3
	Specifikimet teknike		
	Kornizë metalike.		
	Platformë dysheku, laminat kompakt HPL)		
	Rregullimi i lartësisë me hidraulik		
	Trendelenburg dhe trendelenburg i kundërt (hidraulik).		



Specifikacione e AK jane me poshte pozicioni 3

3	Tavoline per ekzaminime Gjinekologjike
	Specifikimet teknike
	Rregullimi i lartësisë me motor
	Rregullimi i mbështetëses me motor
	Mbështetëse e këmbëve
	Trendelenburg me motor
	Kontrolli i grupit të këmbëve.
	Doreza e sipërme ngritëse.
	Mbështetja e krahut në të dy anët
	Jashtë. i zbehtë. 87x216 cm
	Dyshek i zbehtë. 56 x 18 cm
	Lartësia nga 61 deri në 101 cm
	Këndi maksimal i mbështetëses 70 °
	Trendelenburg 12 °
	Pesha 250 kg
	Veshje e trupit të barkut
	Binarët aksesorë
	Enë për grumbullimin e mbetjeve
	Mbulesa e dyshekut antibakterial, rezistente ndaj lëngjeve
	Mbulesa e dyshekut që lahet

Specifikacion e Prodhuesi per poziconi 3

STANDARD FEATURES
• Height adjustment. (motor)
• Backrest adjustment. (motor)
• Footrest. (detachable)
• Trendelenburg (motor)
• Foot set control.
• Upper Lifting Handle. (foldable)
• Arm support on both sides. (adjustable)
• Foot support on both sides. (adjustable)
• Polyurethane knee support on both sides. (adjustable)
• Waste collection container 8 liter. (stainless steel)
• Liquid proof, antibacterial mattress cover.
• Washable mattress cover.
• Towel holders.
• ABS body coating.
• Accessory rails.
• Adjustable balance legs.
• Accessories ; 304 quality stainless steel.
• Electrostatic powder coated frame. (RAL 7035)



Shiko link https://www.turmedonline.com/Urun/gyneacology-and-delivery-table_4953

Specifikim teknike te detyrueshme për pozicionet e cekur me lart janë favorizuese për nje OE te caktuar ne Kosove i cili eshte OE i autorzuar per Kosove i prodhuesi te cekur me lart, sepse te gjitha parametrat teknike te kërkuara ne dosje te tenderit i përputhen ne tërësi produktit-modeli e cekur me lartë.
Ky përpilim ne dosje te tenderit identik te produktit e cekura me lart, pamundëson pjesëmarrjen te gjitha prodhueseve tjerë pra kufizon konkurrencën, sepse këta parametra teknik janë identik për ketë produkt qe i posedon vetëm ky prodhues ne treg shiko dëshmin dhe favorizon prodhuesin ne procedure te hapur te prokurimit.

Kurse Neni 7 –Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi-Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. *Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

Nenin 28 te LPP-se Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për këto pozicione, bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se "*Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik*". Gjithashtu ky përpilim teknike nga njësia e kërkesës është diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrimi ne raport me kushte teknike te konkurrencës/trajtim i barabarte pra specifikacionet teknike duhet të përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese.

4	Shtreter per pacient te urgjences TM- C3033
	Specifikim
	Kornizë
	Platformë dysheku, laminat kompakt HPL)
	Rregullimi i lartësisë me hidraulik
	Trendelenburg dhe trendelenburg i kundërt (hidraulik).
	Rregullimi i mbështetëses me piston gazi
	Rregullimi i pushimit të kofshëve me piston gazi
	Mbështetëse e këmbëve me opcion manuel
	Binarët anësor. (metal)
	Dyshek: I papërshkueshëm nga uji, rezistent ndaj flakës, mbulesë PU anti-bakteriale.
	Poli IV. (Gjatesia e rregullueshme)
	Rrota e pestë. (manovrim dhe kthesë e lehtë)
	Castors me frenim qendror dhe sistem bllokimi drejtimi.
	Parakolpët mbrojtës të këndit.
	Mbajtëse aksesorësh.
	Mbajtëse e bombolave të oksigjenit.
	Raft material.
	Kornizë metalike e veshur me pluhur elektrostatik. (RAL 7016 dhe 1023)
	Ext dim. 196 x 78 cm

https://www.turmedonline.com/Urun/emergency-stretcher_5553

STANDARD FEATURES

- Metal frame.
- Mattress platform. (compact laminate HPL)
- Height adjustment. (hydraulic)
- Trendelenburg and reverse trendelenburg (hydraulic).
- Backrest adjustment. (gas piston)
- Thigh rest adjustment. (gas piston)
- Footrest. (manuel)
- Side rails. (metal)
- Mattress: Waterproof, flame retardant, anti-bacterial PU cover.
- IV pole. (Height adjustable)
- Fifth wheel. (easy maneuver and turn)
- Castors with central brake and direction lock system.
- Protective corner bumpers.
- Accessory holders.
- Oxygen cylinder holder.
- Material rack.
- Electrostatic powder coated metal frame. (RAL 7016 and 1023)

TECHNICAL PARAMETERS

External Dimensions	: 1965 x 780 mm
Mattress Platform	: 1850 x 600 mm
Mattress thickness	: 80 mm

Specifikim teknike te detyrueshme për pozicioni 2 janë favorizuese për një OE te caktuar sepse te gjitha parametrat teknike te kërkuara ne dosje te tenderit i përputhen ne tërësi produktit-e cekur me lartë.
Pra AK ka cek ne Sqarim citim" Referojuni DT" pra është e pa mundur te ofertohet sepse AK ka favorizuar kete prodhues edhe prodhuesi ka thene vetem nje autorzim per Kosove kurse asnjë dilier tjere nuk ka te drejt te jepin autorzim për Kosove.

Edhe pozicion tjera si 5 ,6 dhe 7 jane te perpripiluar per prodhuesit e caktuar pra jane identike dhe nuk jep mundesi ofertim me paisjet te peraferta me devijim me vogela edhe pse ne kemi kerkaur ne AK se ne pyetje sqarues dhe kerkesen per rishqyrtim por fare nuk ke marr per baze edhe pse ne kemi dorzuar fakte dhe deshmi se AK ka favorizuar nej prodhues te caktuar ku kemi cekur me lart, por ne shpresoj se OSHP te kete parasysh deshmi, fakte e cekur me lart ku kemi vertetuar se AK ka favorzaur prodhuesin e cekur me lart dhe te obligoj AK te modifikoj apo te pranoj paisjet me devijime te vogela qe ploteson nevoja e njesis kerkuese dhe qellimin e tyre dhe njeherit OSHP te parandaloj qe AK te kete aktivitet te prokurimit te zhvilloje procedaur e prokurimit ne kundershtim me LPP Neni 7 dhe Neni 28 te LPP .

Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 28 te LPP-se Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për këto pozicione, bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se "*Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik*". Gjithashtu ky përpilim teknike nga njësia e kërkesës është diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrimi ne raport me kushte teknike te konkurrencës/trajtim i barabarte pra specifikacionet teknike duhet të përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese.

Si pale me interes material për ketë aktivitet te prokurimit ne kërkojmë nga OSHP te obligoj AK dhe NJK (njësia e kërkesës) te modifikoj specifikimet teknike te detyrueshme për këtë furnizim, ne mënyre qe te mundësohet konkurrenca ne mes prodhueseve për produktin qe ju kërkoni, pasi qe kjo është procedure e hapur dhe qëllimi i Autoritetit kontraktues sipas LPP-se është trajtimi i barabarte i OE pjesëmarrës për te arritur qëllimin-Parimin e Ekonomicitetit.

Andaj ky parim arrihet vetëm kur termat teknike si ne rastin ne fjalë qe te mundësoj konkurrence maksimale ne mes Operatoreve ekonomik dhe jo kur paraprakisht dihet se cilin prodhues dhe produkt do shpallen fitues për tender.

Pra me keto specfikacione teknike siq jane tani eshte e pa mundur OE tjere te marrin pjese sepse AK ka perpiluar specfikacion tenike ne ate menyre qe OE i favorzuar ka te garantuar qe do te fitoj dhe do rekomandohet për kontrate kete tender pamara parasyshe cmimin e ofertes.
Siq vrehet me lart ky tender eshte ne kundershtime me parime baze te LPP Neni 7 dhe 28 te LPP dhe RrUOPP te cekure me lart.

Eksperti teknik, pasi ka analizuar dëshmitë e ofruara nga OE ankues vlerëson se ne pozicionet 1 dhe 2 specifikacionet i janë përshtatur prodhuesit Aspel.

Po ashtu pozicionet 3 dhe 4 i janë përshtatur prodhuesit Turmed, pra modelin 4- shtretër për paciente të urgjencës TM C-3033

Gjithashtu edhe pozicionet 5,6,7 janë përpiluar për prodhuesit e caktuar si me larte dhe i janë përshtatur këtij prodhuesi.

Eksperti teknik, vlerëson se pretendimet e OE ankues qëndrojnë për pozicionin 1.2.3.4.5.6.7 dhe se keto kërkesa duhet te hiqen nga dosja e tenderit, për faktin se i janë përshtatur prodhuesit Aspel dhe Turmed.

Eksperti shqyrtues/ Teknik si sqarim shtese i rekomandon AK-se qe gjate përmirësimit te kërkesave te dosjes se tenderit të veproj ne harmoni me Nenin 53.7 të LPP-se.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SPITALI SHEIKH ZAYED**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Adnan A. Bala B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi

Lindita Aliaga